



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 11 datë 28.05.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “OBJEKT BANIMI DHE
APART- HOTEL 5, 6 DHE 8 KAT MBI TOKË DHE 1 KAT PARKIM NËN TOKË”,
ME VENDNDODHJE NË RRUGA ISMAIL QEMALI, BASHKIA KAVAJË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të zhvilluesve “Gentry AL Construction” sh.p.k. dhe “Texas Development” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Objekt banimi dhe apart- hotel 5,6 dhe 8 kat mbi tokë dhe 1 kat parkim nën tokë”, me vendndodhje në rruga Ismail Qemali, Bashkia Kavajë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Gentry AL Construction” sh.p.k. dhe “Texas Development” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kavajë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 10.04 / 2026